



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	09.09.2026
REFERENC-Ë:	25/8119/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Graniti & Co" SH.P.K. Shirokë, Suharekë Fabrikë e prodhimit të rrjetave për suvatim në Suharekë
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka kontrolluar kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore, me nr. prot. 25/8119/MMPH, datë 05.11.2025, të parashtruar nga operatori "Graniti & Co" SH.P.K. Shirokë, Suharekë për fabrikën e prodhimit të rrjetave për suvatim në Suharekë

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore për operatorin "Graniti & Co" SH.P.K. Shirokë, Suharekë për fabrikën e prodhimit të rrjetave për suvatim në Suharekë.

Me respekt!





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the
General Secretary*

Nr.: 25/8119/MMPH
Datë: 09.09.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "Graniti & Co" SH.P.K. Shirokë, Suharekë, i ndërpritet procedura administrative për kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore, me nr. prot. 25/8119/MMPH, datë 05.11.2025, për fabrikën e prodhimit të rrjetave për suvatim në ngastrat kadastrale me nr. P-72116046-02785-15 dhe P-72116046-02785-16 në zonën kadastrale Suharekë.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore me nr. prot. 25/8119/MMPH, datë 05.11.2025, të operatorit "Graniti & Co" SH.P.K. Shirokë, Suharekë për fabrikën e prodhimit të rrjetave për suvatim në Suharekë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për

Leje Mjedisore ka kontrolluar lëndën administrativisht dhe në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, me datë 10.07.2026, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Lejen ujore për shfrytëzim të ujit nga ARPL;
- Lejen ujore për shkarkim të ujit nga ARPL.

Operatori ka sjellur pjesërisht dëshmi për plotësimin e dokumtacionit shtesë të kërkuar me datë 06.08.2026, si në vijim:

- Kërkesë drejtuar ARPL se a i nënshtrohet veprimtaria procedurave të Lejes ujore;
- Lejen ujore për shkarkim të ujërave nga fabrika e styroporit për kompaninë "GRANITI&CO" Shirokë, Suharekë, me nr. ref. 5907/21-ARPL, dt. 30.12.2021;
- Lejen ujore për shfrytëzim të ujit nga fabrika e styroporit për kompaninë "GRANITI&CO" Shirokë, Suharekë, me nr. ref. 5906/21-ARPL, dt. 30.12.2021;
- Procesin teknologjik të prodhimit të rrjetave për suvatim.

Si përfundim:

Mungojnë Lejet Ujore të kërkuara nga komisioni për fabrikën e prodhimit të rrjetave për suvatim.

Komisioni për Leje Mjedisore në takimin e mbajtur me datë 18.08.2026, konstatoi se operatori "Graniti & Co" SH.P.K. Shirokë, Suharekë për fabrikën e prodhimit të rrjetave për suvatim në Suharekë, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur më lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së



Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.